



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr 21, date 13/02/2001

**PER  
MIRATIMIN E KRIJIMIT TE NDERMARRJES NR.2 TE PUNETOREVE TE  
QYTETIT**

Në mbështetje të Ligjit 8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” neni 32, pika c, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal në Republikën e Shqipërisë” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë bashkimin administrativ të Ndërmarrjes Komunale të Banesave dhe DDD ne Ndërmarrjen Komunale të Rrugëve, duke krijuar një Ndërmarrje të vetme të emërtuar “Ndërmarrja e Punëtorëve Nr.2, të Qytetit
2. Ndërmarrjet e përfshira në pikën 1 të këtij vendimi me miratimin e këtij vendimi kthehen në sektore duke ruajtur funksionet dhe qëllimet e tyre parësore
3. Struktura e funksionimit të Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit ndodhet bashkëngjitur këtij vendimi. Efektet financiare mbështetur në miratimin e këtij vendimi fillojnë në 1 Mars 2001
4. Për zbatimin e këtij vendimi, kryerjen e procedurave përkatëse, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike dhe Drejtoria Juridike.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**